

VENDIM
Nr.411, datë 23.1.2006

PËR RINOVOMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “ROCK”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.399, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.040/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Radio Rock” sh.p.k. për “Radio Rock”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj